


Programi i Bashkimit Evropian "Përkrahja e Shoqërisë Civile"  
për organizatat e shoqërisë civile



# VLERESIMI I INTEGRITETIT NE POLICINE E KOSOVES



Ky raport është mbështetur  
nga Bashkimi Evropian

**POINTPULSE**   
WESTERN BALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST



**VLERESIMI I  
INTEGRITETIT  
NE POLICINE  
E KOSOVES**

# **VLERËSIMI I INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS**

## **Botuesit**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Rr. Sylejman Vokshi, Blloku B,  
Hyrja 2, Nr. 1, Prishtinë  
Tel: +381 38 221 420  
Email: info@qkss.org  
www.qkss.org  
www.pointpulse.net

## **Autor**

Plator Avdiu

## **Redaktor**

Mentor Vrajolli

## **Dizajni dhe faqosja**

DTP Studio

## **Rreth raporti**

Ky raport botohet si pjesë e aktivitetit “Pulsi i Integritetit dhe Besueshmërisë në Polici në Ballkanin Perëndimor: POINTPULSE”. Ky aktivitet mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Përkrahja e Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA). Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë vetëm të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

## **Rreth POINTPULSE**

Qëllimi i POINTPULSE është të kontribuojë për rritjen e besimit në agjencitë e zbatimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor duke promovuar integritetin policor. Anëtarë të POINTPULSE janë shtatë organizata të shoqërisë civile: Analytica, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Qendra për Studime të Sigurisë, Instituti Alternativa, Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Prishtinë 2016

# TABELA E PËRMBAJTJE

---

PËRMBLEDHJE.....	6
HYRJE .....	7
MBIKËQYRJA E JASHTME.....	8
Mbikëqyrja parlamentare .....	8
Inspektorati Policor i Kosovës .....	10
Institucioni i Avokatit të Popullit .....	12
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.....	13
LLOGARIDHËNIA E BRENSHME .....	15
Plani i integritetit .....	15
Kontroll i brendshëm i Policisë.....	16
Konflikti i interesit dhe deklarimi i pasurisë.....	18
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE .....	22
Praktikat dhe struktura organizative .....	23
Sfidat kryesore.....	26
MENAXHIMI FINANCIAR.....	29
Prokurimi publik.....	29
REKOMANDIME .....	33



## PËRMBLEDHJE

---

Policia e Kosovës ka ndërtuar mekanizmat e vet për qeverisje të brendshme, veçanërisht sa i përket kontrollit të brendshëm. Por, ende mbetet shumë për t'u bërë për profesionalizimin dhe forcimin e këtyre mekanizmave me qëllim ngritjen e integritetit institucional si dhe parandalimin e luftimit të korrupsionit policor. Në këtë vërehet se sfidat më të ndjeshme me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës mbesin menaxhimi i burimeve njerëzore, procesi i reformimit të brendshëm, prokurimi publik dhe parandalimi i shkeljes së detyrave zyrtare nga ana e zyrtarëve policorë.

Nevoja e profesionalizimit të burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës ka shtruar nevojën për ndërmarrjen e reformave në këtë institucion të sigurisë duke nisur nga pensionimi i parakohshëm i zyrtarëve policorë, që si proces ende nuk ka nisur së zbatuari. Dobësi janë evidentuar edhe lidhur me mos-azhurnimin e dosjeve të personelit të Policisë së Kosovës, ku nuk bëhet në baza të rregullta vlerësimi i performancës në punë të personelit policor. Gjithashtu, personeli i Policisë së Kosovës nuk ka sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor në kuadër të punës zyrtare, gjë që mund të dëmtojë burimet njerëzore të Policisë së Kosovës. Dështimi në ofrimin e këtyre sigurimeve për personelin policor dëshmon për mungesën e angazhimit konkret të institucioneve përkatëse për zhvillimin e mëtutjeshëm të Policisë së Kosovës.

Prokurimi publik është një fushë tjetër ku Policia e Kosovës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë sa i përket respektimi të procedurave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik për mbikëqyrjen e kontratave dhe projekteve të ndryshme, të cilat zbatohen nga operatorët ekonomikë. Krahas kësaj, mekanizmat përkatës të këtij institucioni të shmangin dobësitë e raportuara në lidhje me përgatitjen e dosjeve të tenderëve.

Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Inspektoratin Policor të Kosovës, duhet të bashkëpunojnë ngushtë lidhur me përgatitjen e dokumenteve dhe zbatimin e tyre në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit brenda Policisë së Kosovës. Në këtë drejtim, mungesa e planit të integritetit për Policinë e Kosovës dhe plani i veprimtimit për zbatimin në praktikë të këtij dokumenti dëmton përpjekjet për forcimin e integritetit në radhët e Policisë së Kosovës. Ndërkohë, roli i Inspektoratit Policor të Kosovës në mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës të jetë më aktiv, veçanërisht në inspektimin dhe hetimin e zyrtarëve policorë, përfshirë zyrtarët policorë me grada të larta dhe nivelin udhëheqës të Policisë së Kosovës.



---

## HYRJE

---

Qëllimi i këtij raporti për Policinë e Kosovës është vlerësimi i integritetit në këtë institucion. Të dhënat e hulumtimit janë mbledhur përmes aktiviteteve të monitorimit dhe avokimit, intervistave, shqyrtimit të dokumenteve ligjore dhe raporteve si edhe nga burime të tjera alternative. Ky hulumtim ka për synim të identifikojë sfidat kryesore në fushën e integritetit policor, të avokojë për përmirësimin si dhe të ndikojë në demokratizimin dhe profesionalizimin e Policisë së Kosovës.

Raporti përbëhet nga katër pjesë kryesore të integritetit policor në tërësi, duke përfshirë: mbikëqyrjen e jashtme të Policisë së Kosovës, llogaridhënien e brendshme, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe menaxhimin financiar. Si pasojë e mungesës të të dhënave kualitative për efikasitetin e kryerjes së hetimeve për korrupsionin policor, përgjegjësia penale e zyrtarëve policorë në Kosovë nuk është vlerësuar sikurse në raportet tjera për integritetin policor në Ballkanin Perëndimor

Ky raport përmban një pako me rekomandime për secilin indikator të përshkruar që janë të ndërlidhur ngushtë me qeverisjen e brendshme të Policisë. Gjetjet nga ky raport kanë për qëllim të shërbejnë si një mjet avokimi për përmirësimin e mëtejshëm institucional, ndërtimin e kapaciteteve të brendshme dhe fuqizimin e integritetit të Policisë së Kosovës.

Metodat e hulumtimit kualitativ janë përdorur për realizimin e këtij hulumtimi: rishikimi i një varg dokumentesh ligjore, strategjitë e institucioneve përkatëse mbi punën e Policisë së Kosovës, raportet vjetore të Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, sikurse edhe raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare si dhe burime të tjera përkatëse të institucioneve publike të Kosovës.

Të dhënat shtesë janë mbledhur përmes intervistave me përfaqësues të institucioneve që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës dhe me njohës të sektorit të sigurisë në Kosovë. Për më tepër, mbledhja e të dhënave është bërë edhe nga grupet e fokusit me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e jashtme të aktiviteteve të Policisë. Aktivitetet avokuese të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm sa i përket gjetjeve të këtij raporti. Së fundi, edhe arkivat e mediave të Kosovës që kanë raportuar për integritetin policor janë shfrytëzuar si burim i rëndësishëm i informacionit



# MBIKËQYRJA E JASHTME

## Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja e politikave të sektorit të sigurisë në Kosovë, përfshirë Policinë, nga ana e Kuvendit të Kosovës parashihet me Kushtetutën e Kosovës.<sup>1</sup> Akti më i lartë juridik e politik i vendit parashihet që “Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyrë buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë”.<sup>2</sup>

Mbikëqyrja e Policisë nga Kuvendi bëhet përmes disa mekanizmave parlamentar. Në rend të parë është interpelanca kur një grup i deputetëve mund të parashtrijë kërkesë për shqyrtimin e një çështje që ndërlidhet me Policinë në seancë të Kuvendit.<sup>3</sup> Interpelanca, në këtë rast, i kërkohet ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me një çështje të caktuar në Polici, meqë PK-ja funksionon nën autoritetin e kreut të MPB-së. Ndërsa, edhe pyetjet parlamentare të deputetëve për përgjigje me gojë dhe përgjigje me shkrim janë një formë tjetër e mbikëqyrjes së PK-së nga ana e Kuvendit.

Kontrolli parlamentar i PK-së ushtrohet në mënyrë të veçantë nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (KPBSMFSK). Sa i përket Policisë, KPBSMFSK-ja mbikëqyrë shpenzimet dhe menaxhimin financiar të PK-së, kurse në bashkëpunim me IPK-në mbikëqyrë çështjet që kanë të bëjnë me masat disiplinore ndaj pjesëtarëve të Policisë.<sup>4</sup> Ky komision parlamentar mbikëqyr edhe zbatimin e ligjeve të fushëveprimit të tij, me theks të veçantë të Ligjit për Policinë dhe legjislacionin përcjellës që ndërlidhet me punën e PK-së. Në fushën e legjislacionit, komisioni është i detyruar të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe në këtë rast MPB-ja, PK-ja e IPK-ja duhet të raportojnë në komision së paku një herë në vit sa i përket të zbatimit të ligjeve përkatëse.<sup>5</sup> Pos këtyre çështjeve, KPBSMFSK-ja duhet të bashkëpunojë me MPB-në nga e cila mund të kërkojë të dhëna konkrete, në të cilën përfshihen raportet e drejtpërdrejta të ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe të krerëve të Policisë e të IPK-së, kur kjo kërkohet nga Komisioni.<sup>6</sup>

Gjatë vitit 2015, prej 25 mbledhjeve të rregullta të këtij Komisioni, dy herë ka raportuar ministri i unëve të brendshme, tri herë drejtori i përgjithshëm i PK-së, ndërsa ish-kr-

1 Neni 65, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (me amendamentet I-XXIV).

2 Po aty, Neni 125.

3 Neni 44, Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 29 prill 2010. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/rQnaaA>

4 Po aty, fq. 51.

5 Po aty, Neni 73.

6 Po aty, fq. 51.



yeshefi ekzekutiv i IPK-së ka raportuar vetëm një herë në vitin 2015.<sup>7</sup> Prej tri raporteve që KPBSMFSK-ja ka shqyrtuar gjatë vitit 2015, në asnjërin prej tyre nuk përfshihet PK-ja ose MPB-ja, por vetëm IPK-ja, ku ka shqyrtuar raportin e saj vjetor për vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore (janar-dhjetor 2015), anëtarët e komisionit kanë arritur të mbajnë tri dëgjime publike, dy prej të cilave kanë qenë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për PK-në dhe një me MPB-në.<sup>8</sup>

KPBSMFSK po ashtu ka monitoruar Ligjin për PK-në gjatë vitit 2015 si dhe ka hartuar një raport me rekomandime për gjetjet e dala gjatë periudhës monitoruese të vitit 2015. Aty komisioni i rekomandon MPB-së, PK-së dhe IPK-së që në vazhdimësi të ngritin kapacitetet dhe bashkëpunimin në kryerjen e autorizimeve ligjore.

Sa i përket qeverisjes së mirë dhe integritetit, zyrtarëve policor u sugjerohet që të zbatojnë detyrat dhe autorizimet policore në mënyrë të ligjshme, sipas Kushtetutës, ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, standardeve operative, Kodit të Etikës së PK-së dhe standardeve ndërkombëtare për zbatimin e ligjit. Për më tepër, pjesëtarët e PK-së duhet të përfshihen në programe të certifikuara trajnimi dhe edukimi për të njohur më mirë kryerjen e autorizimeve policore, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut sipas parimit të legjitimitetit, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit.<sup>9</sup> Komisioni parlamentar ka rekomanduar që të zbatohet testi i integritetit për zyrtarët policor sipas modelit të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian. Ndërkohë, ligjvënësit i kanë bërë thirrje PK-së që në mënyrë të vazhdueshme të përfshijnë pjesëtarët e gjinisë femërore të PK-së në të gjitha strukturat e Policisë.<sup>10</sup>

Gjithashtu, në këtë raport nga Komisioni kërkohet që Policia të avancojë tutje punën e saj në funksionalizimin dhe standardizimin e formave në sektorët si: policimit të udhëhequr nga inteligjenca, policimit në bashkësi, patrullimit, si dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike me standardet e përvetësuara të kontrollit të turmave dhe trazirave në rastet e prishjes së rendit dhe qetësisë publike.<sup>11</sup> Në fushën e sundimit të ligjit, komisioni ka sugjeruar fuqizimin e marrëdhënieve ndërmjet PK-së me prokurorinë dhe gjykatat e Kosovës. Ndërsa, është rekomanduar edhe themelimi i Policisë Gjyqësore për rritjen e efikasitetit në kryerjen e hetimit të veprave penale nga Policia me qëllim të sigurimit të pavarësisë në hetimet penale.<sup>12</sup>

7 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). Raporti i punës për vitin 2015, fq. 5.

8 Po aty.

9 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, fq. 1.

10 Po aty, fq. 2.

11 Po aty.

12 Për më tepër detaje lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë nga komisioni parlamentar, shih: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.



Pavarësisht këtyre aktiviteteve, puna dhe dinamika e komisionit parlamentar ka qenë peng i krizës politike në vend e cila fillojw që nga mesi i 2014, 2015 dhe vazhdoi edhe në katër muajt e parë të vitit 2016. Si rrjedhojë, anëtarët e komisionit nga radhët e opozitës nuk kanë marrë pjesë në shumë prej mbledhjeve të komisionit, veçanërisht gjatë vitit 2015 dhe në pjesën e parë të vitit 2016. Deputetët e opozitës kanë bojkotuar punimet e komisionit dhe të Kuvendit në përgjithësi për shkak të kundërshtimit të Marrëveshjes për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë dhe për demarkacionin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Sidoqoftë, kjo ka ndikuar edhe në numrin e takimeve të KPBSMFSK-së për mbikëqyrjen parlamentare të Policisë dhe ka shkaktuar probleme në vet efikasitetin e mbikëqyrjes civile të sektorit të sigurisë në përgjithësi nga Kuvendi.<sup>13</sup>

Mbikëqyrja parlamentare, me theks të veçantë ajo e KPBSMFSK-së, ballafaqohet me mungesën e kapaciteteve profesionale për shkak të numrit të vogël të stafit administrativ.<sup>14</sup> Siç shihet nga aktivitetet e komisionit për vitin 2015, mbikëqyrja parlamentare e institucioneve të sigurisë është ende sipërfaqësore dhe funksionimi i tyre nuk mbikëqyret në mënyrë më të thukët nga Kuvendi.<sup>15</sup> Për këtë arsye, Kuvendi duhet të shfrytëzojë buxhetin e vet për të investuar në burimet profesionale të komisionit përmes angazhimit të ekspertëve që kanë njohuri në çështjet e sigurisë dhe punëve të brendshme. Edhe pse deri më tash KPBSMFSK kryesisht është mbështetur tek organizatat e ndryshme ndërkombëtare, tashmë është nevojë urgjente ngritja e kapaciteteve të brendshme profesionale në mënyrë që përmes analizave dhe ekspertizave të bëhet një mbikëqyrje e mirëfilltë parlamentare e sektorit të sigurisë.<sup>16</sup>

## Inspektorati Policor i Kosovës

Roli, veprimtaria dhe aktivitetet e Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) në mbikëqyrjen e PK-së gjatë vitit 2015 janë trajtuar në seksionet e mëparshme në kuadër të këtij raporti (shih seksionin “Kontrolli i brendshëm” dhe seksionin “Pavarësia në vendim-marrje e Policisë”). Ky institucion, siç është analizuar në këtë raport, ka mandat për të bërë hetime penale, hetimeve disiplinore dhe hetimin e integritetit ndaj zyrtarëve policor, si dhe inspektimeve të rregullta e të jashtëzakonshme në PK.

Në vitin 2015 ka IPK-ja nisur projektin e regionalizimit, përkatësisht janë hapur tri zyre rajonale të këtij institucioni në Gjilan, Prizren dhe Mitrovicën Veriore. Kjo shihet

13 Kosovar Centre for Security Studies. Annual Report 2015 – Assembly of Kosovo (Period covered: January-December 2015), fq. 5.

14 Po aty, fq. 11.

15 Kontribute të mbledhura nga konferenca e QKSS-së me temën: “Vlerësimi i integritetit në Policinë e Kosovës”, 26 nëntor 2015, Prishtinë.

16 Po aty.



si mundësi e mirë për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të IPK-së me qytetarë nga rajonet e ndryshme të Kosovës. Zyrat rajonale të IPK-së do të duhej të shërbejnë për parandalimin e shkeljeve penale e disiplinore të policëve, por edhe në ngritjen e integritetit të punonjësve të Policisë.<sup>17</sup> Ndërsa, që nga maji i vitit 2016 IPK-ja udhëhiqet nga Kryeshefi i ri Ekzekutiv, Hilmi Mehmeti, i cili ishte shpallur si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë nga ana e MPB-së.<sup>18</sup>

Në kuadër të mbikëqyrjes së punës së IPK-së, KPBSMFSK-ja mbikëqyr edhe zbatimin e Ligjit për IPK-në. Gjatë vitit 2013 komisioni parlamentar ka dal me një raport për mbikëqyrjen e të këtij Ligji ku kishte gjetur disa parregullsi në funksionimin e IPK-së. Aty përmendet se Ligji për IPK-në zbatohet vetëm pjesërisht. Për më tepër, theksohet se IPK-ja kishte shkelur ligjin gjatë rekrutimit të personelit pa shkollim adekuat.<sup>19</sup> Parregullsi ishin vërejtur edhe tek menaxhimi i buxhetit, kur IPK-ja kishte shpërblyer personelin e vet pa bazë ligjore me dy paga shtesë brenda vitit kalendarik.<sup>20</sup> Ndërsa, në raport me Policinë, KPBSMFSK-ja kishte kritikuar IPK-në sa i përket hetimeve penale ndaj zyrtarëve policor. Komisioni parlamentar ka kritikuar se kishte pasur paraqitje publike joprofessionale të personelit të IPK-së gjatë arrestimit të pjesëtarëve të Policisë të dyshuar për vepra penale ne disa raste. Megjithatë, KPBSMFSK-ja nuk ka bërë të ditur se në cilat raste IPK-ja ishte treguar joprofessionale sa i përket kësaj çështjeje.<sup>21</sup> Gjatë mbikëqyrjes së IPK-së, komisioni parlamentar kishte gjetur se ka pasur zbatim të standardeve të dyfishta nga IPK-ja kur ka dhënë rekomandime për suspendimin e zyrtarëve policor.<sup>22</sup> Komisioni parlamentar kishte dal me disa rekomandime për evitimin e këtyre parregullsive, por nuk dihet nëse këto të gjetura janë adresuar nga ana e IPK-së.<sup>23</sup>

Nga ana tjetër, duke e ditur që buxheti i IPK-së ndahet nga MPB-ja dhe financiarisht varet nga Qeveria e Kosovës, ekzistojnë shqetësime lidhur me paanshmërinë e IPK-së në hetimin e shkeljeve ose keqpërdorimeve të mundshme që ndodhin në Polici. Funksionimi i IPK-së nën autoritetin e MPB-së, njëjtë siç funksionon edhe PK-ja, ka shkaktuar reagime se hetimet penale që bën IPK-ja ndaj zyrtarëve policor vështirë se

17 Inspektorati Policor i Kosovës. Raporti vjetor 2015, f. 40. Qasur më 5 maj 2016, në: <<http://goo.gl/WOODTr>>

18 Shih: <<http://goo.gl/nuxlHa>>. Qasur më 9 maj 2016.

19 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së. (Qershor 2013). Raport: Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-231 për IPK, fq. 9.

20 Po aty.

21 Po aty.

22 Po aty.

23 Për më tepër detaje lidhur me rekomandimet e komisionit parlamentar për IPK-në drejtuar deputetëve të Kuvendit, shih: Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (19 qershor 2013). Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.



mund të jenë të pavarura dhe objektive.<sup>24</sup> Madje, Avokat i Popullit ka kërkuar që IPK-së t'i hiqet kompetenca e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policor me arsyen se kur bëhet fjalë për dyshime të veprave penale, qoftë edhe të pjesëtarëve të PK-së, kjo çështje duhet t'i kalohet me automatizëm organeve të drejtësisë.<sup>25</sup> Në vend të kësaj, IPK-ja do të duhej të konsolidonte dhe forconte mekanizmat e vet të brendshëm për të zhvilluar konceptin e etikës profesionale ndaj zyrtarëve policor në baza të rregullta.<sup>26</sup> Si institucion që detyrë parësore ka mbikëqyrjen e PK-së, funksioni kryesor i IPK-së duhet të fokusohet në realizimin e politikave afatmesme për fuqizimin e etikës dhe integritetit të personelit policor, sidomos në zhvillimin e masave kundër korrupsionit policor.

### Institucioni i Avokatit të Popullit

Institucion tjetër me rëndësi për mbikëqyrjen e PK-së është Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Gjatë vitit 2015 është zgjeruar bashkëpunimi ndërmjet IAP-së dhe PK-së gjatë takimeve të përbashkëta që kanë pasur drejtuesit e këtyre dy institucioneve sa i përket të drejtave të njeriut. Policia ka nxjerrë një udhëzim që obligon personelin policor për të zhvilluar komunikim të rregullt me IAP-në për qasjen në të dhënat dhe informatat e PK-së me kohë.<sup>27</sup>

Sa i përket mbikëqyrjes së PK-së në rrafshin e të drejtave dhe lirive të njeriut, IAP-ja ndër çështjet më problematike e ka konsideruar mekanizmin e ankesës. Avokati i Popullit nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga policët për shkeljen e të drejtave të njeriut, duke vlerësuar se kjo mund të jetë më shumë si pasojë e mundësisë për t'u diskriminuar personeli policor në vendin e punës. Sipas IAP-së, personeli policor, sikurse edhe punonjësit e sektorit publik, kanë frikë të ankohen për shkak se mund të jenë viktimë e hakmarrjes dhe subjekt i presioneve të ndryshme, qoftë edhe me largimin nga puna nga eprorët e tyre nëse ankohen për shkelje të të drejtave të njeriut.<sup>28</sup>

IAP-ja mbikëqyrë punën e Policisë me rastin e tubimeve publike dhe protestave. Me përjashtim të protestës së 28 nëntorit 2015, ku IAP-ja ka konstatuar se ekzistojnë pretendime serioze për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Policia,<sup>29</sup> në protestat e tjera

24 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, fq. 17-18. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

25 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

26 Kontribute të mbledhura nga konferenca e QKSS-së me temën: "Vlerësimi i integritetit në Policinë e Kosovës", 26 nëntor 2015, Prishtinë.

27 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

28 Po aty.

29 Për vlerësimet e Avokatit të Popullit në lidhje me intervenimin e Policisë në protestën e 28 nëntorit 2015, shih seksionin e këtij raporti me titull: "Pavarësia dhe vendimmarrja në Polici".



vlerësohet se PK-ja ka qenë shumë më e kujdesshme dhe më e matur në këtë drejtim. Avokati i Popullit nuk ka ngritur dyshime ose pretendime se në protestat tjera kishte pasur tejkalim të autorizimeve ose sjellje jo korrekte të zyrtarëve policor ndaj protestuesve.<sup>30</sup>

Ndërkohë, me ndryshimet e reja të legjislacionit për Avokatin e Popullit, ky institucion vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.<sup>31</sup> IAP-ja ka të drejtë të bëjë inspektime të rregullta në të gjitha qendrat dhe vendet, ku njerëzit mbahen të privuar prej lirisë. Avokati i Popullit synon të bëjë inspektime në stacionet policore për të evituar të gjitha shkeljet që mund të ndodhin sa i përket kësaj çështjeje.<sup>32</sup>

## Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Funksioni i mbikëqyrjes demokratike të institucioneve publike në fushën e kontrollit ekonomik dhe financiar ushtrohet përmes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP). ZAP-i bënë auditimin vjetor të pasqyrave financiare të institucioneve publike. Sidoqoftë, ZAP-i nuk përgatit raport të veçantë auditimi për Policinë, por atë e përfshin në kuadër të raportit vjetor për menaxhimin financiar të MPB-së.

Në raportin për vitin 2014, ZAP-i ka vlerësuar se PK-ja ka forcuar dukshëm kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave dhe ka zbatuar ndëshkimet e parapara me kontratë për vonesat që janë shkaktuar nga operatorët ekonomikë.<sup>33</sup> Ndërkohë, ZAP-i ka rekomanduar vazhdimisht forcimin e kontrolleve të flotës së PK-së, megjithatë menaxhimi i automjeteve në Polici nuk është në nivelin e kënaqshëm. Shumë automjete policore presin për servisim prej vitit 2009, derisa pjesa më e madhe e tyre nuk janë servisuar si pasojë e mungesës së pjesëve rezervë.<sup>34</sup> ZAP-i e ka vlerësuar si rrezik numrin e madh të automjeteve të Policisë që presin për servisim për arsye se jetëgjatësia e këtyre automjeteve është mjaft e kufizuar.<sup>35</sup> Për këtë rast, i është rekomanduar ministrit të Punëve të Brendshme të rishikojë arsyet e mos adresimit të këtij rekomandimi të ZAP-it nga Policia dhe të përcaktojë masa shtesë për forcimin e kontrolleve në këtë njësi. Ndërsa, vërejtje të tjera kanë të bëjnë me mirëmbajtjen jo të mirë të dosjeve të

30 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

31 Neni 17, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.

32 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, f. 17. Qasur më 9 maj 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

33 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. (Qershor 2015). Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, fq. 15. Qasur më 12 maj 2016, në: <<http://goo.gl/6XEVRp>>

34 Po aty, fq. 22.

35 Po aty, fq. 22.



personelit në PK ku rekomandimet për këtë çështje janë adresuar vetëm pjesërisht nga ana e Policisë.<sup>36</sup>

Ndërkohë, KPBSMFSK-ja ka sugjeruar PK-në të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it sa i përket pasqyrave financiare vjetore rreth shpenzimeve buxhetore dhe rekomandimet tjera.<sup>37</sup> Komisioni parlamentar ka vërejtur se Policia i zbaton vetëm pjesërisht rekomandimet e ZAP-it në lidhje me shpenzimet buxhetore.<sup>38</sup> Nga ana tjetër, Policia nuk ka ofruar të dhëna lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimet e ZAP-it.

---

36 Po aty, fq. 30.

37 Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. (Dhjetor 2015). Raport me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, fq. 1.

38 Po aty, fq. 21.



# LLOGARËDHËNIA E BRENDSHME

## Plani i integritetit

Për të forcuar qeverisjen e brendshme dhe për të parandaluar korrupsionin në Polici kjo e fundit ende nuk e ka planin për zhvillimin e integritetit institucional (ose Planin e Integritetit). Ky plan do të duhej të shërbente si udhërrëfyes për PK-në për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme në Polici dhe të aferave të ndryshme të korrupsionit dhe marrjeve të mitos. Gjithashtu, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit më të mirë dhe adekuat të buxhetit të PK-së, sidomos për shpenzimet që kanë të bëjnë me aktivitetet e Policisë në fushën e prokurimit publik.

Për më tepër, plani i integritetit do të duhet të vinte theksin edhe tek parandalimi i keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar të personelit policor gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Planin e integritetit duhet të përmbajë planin e veprimit që do të parashihte objektivat e Policisë për periudhën pesëvjeçare për zhvillimin e integritetit dhe besueshmërisë së forcave të rendit. Ndërsa, për zbatimin e tij do të duhej të jenë përgjegjës mekanizmat për kontrollin e brendshëm të Policisë me detyra dhe afate të përcaktuara qartazi.

Mungesa e planit të integritetit është konstatuar edhe në Strategjinë kundër korrupsionit 2013-2017. Në këtë dokument thuhet se këto plane kanë për qëllim të sigurojnë që çdo punonjës publik duhet të respektojë rregullat etike dhe integritetin për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit në minimum,<sup>39</sup> përfshirë edhe institucionin e Policisë. Për luftimin e korrupsionit dhe ndërtimin e besimit, kjo strategji apelon për forcimin e kontrollit të brendshëm e të mekanizmave disiplinorë brenda PK-së.<sup>40</sup> Për më tepër, PK-së i është kërkuar të organizojë trajnime në fushën e menaxhimit dhe hetimit të korrupsionit, si dhe të kryejë kontrole efektive të brendshme me qëllim të uljes së korrupsionit në Polici.<sup>41</sup> Nuk dihet se deri në çfarë mase PK-ja i ka arritur objektivat e kësaj strategjie dhe ato të planit të veprimit për luftimin e korrupsionit policor.

Ndërkohë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, PK-ja pritet të nis një pilot-projekt të integritetit policor për parandalimin e korrupsionit përmes një sistemi të paralajmërimit të hershëm. Ky sistem parasheh që Policia të ketë zyrtarë të veçantë që merren vetëm me luftimin e korrupsionit që mund të ndodh brenda institucionit. Gjithashtu,

39 Agjencia kundër Korrupsionit. (Nëntor 2012). Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, f. 22. Qasur më 6 maj 2016, në: <goo.gl/MxxdS9>.

40 Po aty, f. 27.

41 Agjencia kundër Korrupsionit. (Nëntor 2012). Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, fq. 28-29. Qasur më 6 maj 2016, në: <goo.gl/MxxdS9>.



menaxhmenti i lartë i Policisë, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshëm të saj do të këshillohen për të ndërmarrë me kohë masa parandaluese për luftimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në PK.<sup>42</sup>

## Kontroll i brendshëm i Policisë

Policia e Kosovës i ka mekanizmat e vet të kontrollit të brendshëm përmes të cilëve mbikëqyrë, kontrollon dhe heton veprimet e zyrtarëve policor gjatë detyrës zyrtare. Këta mekanizma kanë të drejtë të hetojnë të gjitha rastet disiplinore për shkelje të rënda dhe të lehta deri në gradën e nënkolonelit policor, por jo edhe zyrtarët policor me grada më të larta dhe stafin ekzekutiv të Policisë.<sup>43</sup> Ndërsa, hetimet për personelin që ka grada më të larta në PK dhe për stafin ekzekutiv të Policisë hetime ka të drejtë të ndërmerr IPK-ja.<sup>44</sup> Inicimi i lëndëve disiplinore brenda për brenda PK-së ndaj personelit policor bëhet në tri mënyra: (i) përmes inicimit të brendshëm nga ana e mbikëqyrësit, (ii) me ankesë të qytetarit dhe (iii) sipas detyrës zyrtare. Përveç kësaj, mekanizmat policor të kontrollit të brendshëm janë përgjegjës për shqyrtimin dhe shqiptimin e masave disiplinore për lëndët disiplinore që hetohen brenda PK-së.<sup>45</sup>

Një prej rasteve më të rënda të evidentuara gjatë kësaj periudhe kishte ndodhur në prill të vitit 2016 kur një zyrtar policor kishte shtënë me armë ndaj një qytetari afër stacionit policor në Deçan. Plagët e marra nga të shtënat me armë kishin rezultuar me vdekjen e këtij të fundit.<sup>46</sup> Sipas të dhënave të Policisë, zyrtari policor e kishte përdorur armën e tij zyrtare në vetëmbrojtje, përkatësisht me qëllim të “parandalimit të sulmit ndaj tij”.<sup>47</sup> Megjithatë, nuk ishte konfirmuar që viktimia mbante armë në momentin kur u qëllua nga polici<sup>48</sup> në orët e hershme të mëngjesit. Në media është raportuar se IPK-ja dhe Prokurori i Shtetit kanë ndërmarrë “hetime intensive” lidhur me këtë rast.<sup>49</sup> Për më tepër, Prokurori i Shtetit kishte autorizuar masën e ndalimit 48-orëshe për policin në fjalë, ndërsa IPK-ja kishte rekomanduar masën e suspendimit ndaj tij.<sup>50</sup> Ndërsa, Gjykata Themelore në Pejë kishte caktuar masën e paraburgimit për 30 ditë ndaj zyrtarit policor i cili kishte qëlluar me armë zyrtare.<sup>51</sup> Në arsyetimin e gjykatës për këtë

42 Kontributet e mbledhura nga dëgjimi publik i Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë më 15 dhjetor 2015.

43 Përgjigjet me shkrim të PK-së të dërguara në formë elektronike në QKSS më 29 prill 2016.

44 Po aty.

45 Po aty.

46 Shih: <goo.gl/CQTrIN>. Qasur më 16 shtator 2016.

47 Po aty.

48 Shih: <goo.gl/Bpr01D>. Qasur më 16 shtator 2016.

49 Shih: <goo.gl/BhbyLq>. Qasur më 16 shtator 2016.

50 Po aty.

51 Shih: <goo.gl/LL9jU5>. Qasur më 16 shtator 2016.



vendim ishte përmendur mundësia që zyrtari policor mund të ikë dhe të ndikojë te dëshmitarët e rastit. Ndërsa, kërkesën për paraburgim e kishte bërë prokurori i rastit nën dyshimin se polici ka kryer veprën penale të vrasjes.<sup>52</sup> Në seancën e mbajtur në gjykatë pas vrasjes, zyrtari policor ishte mbrojtur duke thënë se ai ndaj të cilit kishte shtënë më armë në vetëmbrojtje nuk ishte një “qytetar i thjeshtë dhe i ndershëm”.<sup>53</sup> Për më tepër, ai ishte shprehur se ky person kishte qenë i dënua për 10 vjet dhe i dyshuar për vepra të ndryshme penale për PK-në në Deçan.<sup>54</sup>

Rast tjetër i shpërfilljes së detyrave zyrtare nga ana e zyrtarëve policorë ndodhi në shtator të vitit 2016 kur këta të fundit nuk e kontrolluan deputetin dhe nënkryetarin e PDK-së, Adem Grabovci para se të hynte në ndërtesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës. Sipas rregullave në fuqi kushdo që hyn në këtë ndërtesë duhet të kontrollohet paraprakisht nga policët. Kjo parashihet edhe me Rregulloren për ruajtjen, sigurimin dhe qasjen në objektet shtetërore dhe me Procedurat Standarde të Operimit të Drejtorisë për Sigurimin e Objekteve dhe Personaliteteve me Rëndësi të Veçantë.<sup>55</sup> Sidoqoftë, kjo rregull nuk ishte zbatuar si në rastin e mësipërm. Si rrjedhojë e kësaj, PK-ja kishte njoftuar se ka ndërmarë masa të nevojshme procedurale ndaj veprimeve të zyrtarëve policorë që dyshohet se kishin “neglizhuar” punën e tyre.<sup>56</sup> Në këtë rast, tre policët që kishin qenë tek hyrja si përgjegjës për kontrollim janë suspenduar 48 orë me pagesa nga PK-ja.<sup>57</sup> Ndërkohë, ndaj tyre kanë nisur procedurat e brendshme disiplinore.

Gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht në muajin shtator të këtij viti u arrestua një zyrtar policor nga kolegët e tij të Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotik të PK-së nën dyshimin se transportonte narkotikë për dy grupe të ndryshme kriminale.<sup>58</sup> Zyrtari policor i arrestuar në flagrancë, sipas hetimeve të bëra nga PK-ja rreth tre muaj për këtë rast, kishte transportuar disa herë narkotikë për këto grupe kriminale me qëllim transportimin e narkotikëve drejt Podujevës. Ndërsa, kur ishte arrestuar, atij i ishin gjetur në automjet rreth 15 kilogram marihuanë në përpjekje për ta dërguar në vendin e caktuar. Sipas të dhënave të PK-së, narkotikët hynin në Kosovës përmes Shqipërisë, transportoheshin deri në rajonin e Pejës dhe më pas destinacion kishin Podujevën me qëllim të trafikimit drejt shteteve të Bashkimit Evropian.<sup>59</sup> Gjatë operacionit të PK-së, zyrtarit policor i ishte bastisur shtëpia me

52 Po aty.

53 Shih: <goo.gl/1AOrrz>. Qasur më 16 shtator 2016.

54 Po aty.

55 Shih: <goo.gl/1xd1XG>. Qasur më 16 shtator 2016.

56 Po aty.

57 Po aty.

58 Adelina Ahmeti. (24 shtator 2016). Aksioni: Arrestimi i Policit për Transport Marijuane. Kallxo.com. Qasur më 25 shtator 2016, në: <goo.gl/GCbHY0>.

59 Shih video-materialin e emisionit “Drejtësia në Kosovë”, 24 shtator 2016, në: <goo.gl/JuaqOK>. Qasur më 25 shtator 2016.



objektet përcjellëse, ku i ishin konfiskuar nga PK-ja arma dhe mjetet tjera të cilat ai i posedonte.<sup>60</sup>

Ndërsa, sa i përket aktiviteteve të IPK-së në raport me ankesat ndaj Policisë, gjatë vitit 2016 ajo ka pranuar 628 ankesa kundër zyrtarëve policorë. Prej këtij numri të ankesave, 390 prej tyre nuk kanë pasur të bëjnë me elemente të veprës penale dhe IPK-ja i ka dërguar në Drejtorinë e Standardeve Profesionale (DSP) të PK-së meqë janë cilësuar si shkelje disiplinore nga IPK-ja. Ndërsa, gjatë pjesës së parë të vitit 2016 (janar-qershor) 109 zyrtarë policorë, përkatësisht 1.4 përqind e numrit total të zyrtarëve policorë janë hetuar nga IPK-ja nën dyshimin se kanë kryer vepra penale.<sup>61</sup> Si pasojë e hetimeve të IPK-së, prej këtyre zyrtarëve policorë të hetuar, IPK-ja ka rekomanduar suspendimin e 24 policëve të dyshuar për vepra penale. Rekomandimi për suspendime nga IPK-ja kishte ardhur si pasojë e procedurave administrative për të mos penguar zhvillimin e hetimeve ndaj zyrtarëve policorë.<sup>62</sup>

Veprat të cilat më së shpeshti i heton IPK-ja ndaj PK-së janë rrezikimi i trafikut publik, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, lëndime të lehta, keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimeve dhe vepra të tjera. Rastet penale të cilat i heton IPK-ja i ndërmerr në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit. Por, pavarësisht këtyre statistikave, nuk dihet se deri në cilën fazë janë zhvilluar këto hetime dhe nuk dihet as për rezultatin e tyre deri më tash.<sup>63</sup>

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2016 (janar-tetor) vërehet se IPK-ja nuk ka qenë aktive sa i përket inspektimeve ndaj PK-së kur kjo krahasohet me vitin paraprak. Derisa në vitin 2015 IPK-ja kishte publikuar gjithsej tetë raporte të ndryshme inspektive për PK-në,<sup>64</sup> gjatë vitit 2016 (deri në gjysmën e dytë të muajit tetor) ky institucion ka publikuar vetëm dy raporte të inspektimit.

## Konflikti i interesit dhe deklarimi i pasurisë

Korniza ligjore sa i përket parandalimit të konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës vite më parë. Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik është miratuar në vitin 2011. Qëllimi i tij është parandalimi i konfliktit ndërmjet interesit publik dhe

60 Po aty.

61 Nikolla, A. (20 shtator 2016). Për 6 muaj, 109 policë nën hetime. Zëri. Qasur më 21 shtator 2016, në: <goo.gl/IVKEZZ>.

62 Po aty.

63 Po aty.

64 Shih raportet e inspektimit të IPK-së në: <goo.gl/6cLKRI>. Qasur më 5 tetor 2016.



interesit privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksionit publik.<sup>65</sup> Ndërsa, objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, subjekteve, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve ndërmjet konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit të lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik.<sup>66</sup> Sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), mosmiratimi i ndryshimeve të këtij ligji ka vështirësuar përmbushjen e mandatit të AKK-së lidhur me parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit. Kjo për shkak se gjatë zbatimit të ligjit siç është në formën aktuale janë vërejtur paqartësi dhe zbrazëtira që e kanë bërë më të vështirë punën e AKK-së, veçanërisht sa i përket ushtrimit të dy e më shumë pozitave në të njëjtën kohë nga zyrtarët e lartë publik të institucioneve të Kosovës.<sup>67</sup>

Megjithatë, ky ligj nuk është në harmoni me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 04/L-082). Derisa në njërën anë Kodi Penal parasheh që shkaktimi i konfliktit të interesit nga personat zyrtarë është vepër penale,<sup>68</sup> në anën tjetër, sipas ligjit aktual konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik është vetëm kundërvajtje, ku parashihen gjoba të ndryshme për zyrtarët që janë në konflikt të interesit.<sup>69</sup> Për këtë arsye Ligji aktual për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik duhet të ndryshohet dhe të jetë në pajtim me Kodin Penal sa i përket konfliktit të interesit, që e trajton këtë të fundit si vepër penale.

Ndërsa, Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është miratuar në vitin 2011 dhe së fundi është amendamentuar në vitin 2014. Ky ligj detyron zyrtarët e lartë publik për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e AKK-së për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre.<sup>70</sup> Përveç tjerash, ky ligj rregullon procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të hyrat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë publik, anëtarët e familjes si dhe sanksionet e përcaktuara, si dhe gjithashtu rregullon procedurën e deklarimit, kontrollit për dhuratat dhe prejardhjen e tyre të pranuar nga të gjithë personat zyrtarë.<sup>71</sup>

65 Neni 1, Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

66 Po aty, Neni 2.

67 Agjencia kundër Korrupsionit. (Mars 2016). Raport Vjetor Janar – Dhjetor 2015. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, f. 1. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/nsV1eT>.

68 Neni 424 dhe Neni 441, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082.

69 Neni 20, Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

70 Neni 1, Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

71 Po aty, Neni 2.



Sa i përket rasteve të mundshme të konfliktit të interesit të zyrtarëve të Policisë, në raportin vjetor të AKK-së për vitin 2015 nuk është evidentuar ndonjë rast i konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë të PK-së.<sup>72</sup> Ndërsa, për vitin 2016 nuk ka të dhëna për konflikt të interesit të zyrtarëve të Policisë. Çështja e konfliktit të interesit duket të jetë shumë sfiduese për institucionin e Policisë. Kur ishte bërë vlerësimi i rrezikut nga fenomeni i korrupsionit, PK-ja e ka identifikuar konfliktin e interesit si rrezik të intensitetit të lartë për zyrtarët e saj. Rrjedhimisht, AKK-ja i ka sugjeruar PK-së që për forcimin e integritetit të nxjerrë një rregullore të brendshme për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit brenda për brenda Policisë.<sup>73</sup> Sidoqoftë, ende nuk dihet nëse PK-ja e ka nxjerrë një rregullore të tillë si masë parandaluese për përfshirjen e zyrtarëve policorë në raste të konfliktit të interesit.

Lidhur me deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë për vitin 2016, numri total i zyrtarëve të lartë të PK-së që kanë qenë të obliguar të deklarojnë pasurinë ka qenë 54 sosh.<sup>74</sup> Në mesin e tyre përfshihen Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, dy zëvendës drejtorët e PK-së, drejtorët e departamenteve përkatëse të Policisë, drejtorët e drejtorive të ndryshme që funksionojnë brenda PK-së, drejtorët e DRP-ve të PK-së dhe zyrtarë të tjerë të lartë të PK-së. Nuk ka të dhëna nëse ndonjëri prej zyrtarëve të lartë të Policisë nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2016 apo nëse ka bërë deklarim të rremë të pasurisë në AKK.

Ndërkaq, AKK-ja përmes metodës së hedhjes së shortit (në mënyrë të rastësishme) ka përzgjedhur zyrtarët e lartë të institucioneve publike të cilët do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë nga ana e AKK-së në bazë të deklarimit të pasurisë së tyre në vitin 2016.<sup>75</sup> Në këtë mënyrë, kontrollit të pasurisë do t'i nënshtrohen edhe disa prej zyrtarëve të lartë të PK-së, duke përfshirë menaxhmentin e Policisë, disa prej drejtorëve të DRP-ve të PK-së, si dhe drejtorët e departamenteve të Policisë.<sup>76</sup>

Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për deklarimin e dhuratave të pranuar nga institucionet publike gjatë vitit 2015, kuptohet se PK-ja gjatë vitit 2015 ka pranuar dy dhurata protokollare, të cilat i ka deklaruar në AKK.<sup>77</sup> Sidoqoftë, në raportin e AKK-së nuk ka të

72 Agjencia kundër Korrupsionit. (Mars 2016). Raport Vjetor Janar – Dhjetor 2015. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, fq. 24-26. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/nsV1eT>.

73 Intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencisë kundër Korrupsionit, 15 shkurt 2016.

74 Agjencia kundër Korrupsionit - Deklarimi i rregull vjetor 1 – 31 mars 2016. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/Aj4nzG>.

75 Shih komunikatën e AKK-së të datës 16 qershor 2016 në: <goo.gl/hEgllZ>. Qasur më 17 shtator 2016.

76 Agjencia kundër Korrupsionit – Lista e zyrtarëve të lartë publik që do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/KGe9nb>.

77 Agjencia kundër Korrupsionit. (Qershor 2016). Raport – Deklarimi i dhuratave të pranuar nga institucionet gjatë vitit 2015. Prishtinë: Agjencia kundër Korrupsionit, fq. 1-2. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/RDlylR>.



dhëna se cila është vlera e këtyre dhuratave të pranuar nga PK-ja dhe se nuk kush kjo e fundit i ka pranuar ato.



## MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Burimet njerëzore në Polici rregullohen në mënyrë të përgjithshme përmes Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë. Sa i përket personelit policor, Policia e Kosovës (PK), sipas kornizës aktuale ligjore, ka këto kategori të të punësuarve: a) zyrtarët policor që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe kryejnë autorizimet policore; b) stafin civil për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet për të ushtruar autorizime policore; dhe c) kadetët policorë.<sup>78</sup>

Stafi civil i PK-së është pjesë e shërbimit civil të Kosovës, ndërsa zyrtarët policor të Policisë nuk bëjnë pjesë në kuadër të shërbimit civil.<sup>79</sup> As Ligji për Policinë, Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe as Ligji i Punës nuk përshkruajnë se cila është marrëdhënia e punës e zyrtarëve policor. Sidoqoftë, marrëdhënia e punës e personelit të PK-së rregullohet përmes akteve nënligjore të Policisë për të tria këto kategori të personelit dhe çështje të tjera të burimeve njerëzore të këtij institucioni. Megjithatë, ndryshe nga institucionet tjera publike, PK-ja nuk i publikon aktet e veta nënligjore që rregullojnë çështje të ndryshme me interes për institucionin. Sipas Policisë ato nuk publikohen për shkak se janë kryesisht dokumente që rregullojnë çështje të brendshme të PK-së. Ndërsa, të gjithë ata që duan të kenë qasje në këto dokumente duhet të bëjnë kërkesë zyrtare në Polici, siç e parasheh Ligji për Qasje në Dokumente Publike.<sup>80</sup>

Sipas Planit Zhvillimor 2016-2020 të PK-së, kjo e fundit do të investojë në profesionalizimin dhe avancimin e burimeve njerëzore. Aty thuhet se rëndësi e madhe do t'i kushtohet ngritjes së avancimit dhe kryerjes së detyrave duke zbatuar standardet më të mira për personelin policor përmes sistemit të menaxhimit të personelit, trajnimeve në vazhdimësi dhe kujdesit ndaj shëndetit.<sup>81</sup> Në fushën e profesionalizimit të burimeve njerëzore, Policia i ka vënë vetes disa objektiva, siç janë: zhvillimi i karrierës së punonjësve të PK-së në përputhje me performancën në punë; avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit në PK; kujdesi shëndetësor për të gjithë të punësuarit përmes kujdesit shëndetësor efikas; dhe ngritja e cilësisë së programeve trajnuese.<sup>82</sup>

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pas ndryshime të kornizës ligjore për menaxhimin e burimeve njerëzore në PK.

78 Neni 44, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë.

79 Shih Nenin 3 dhe Nenin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

80 Intervistë me një zyrtar të lartë të PK-së, 18 dhjetor 2015.

81 Policia e Kosovës. Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020, f. 13. Qasur më 16 prill 2016, në: <<http://google.com/search?q=gl/3w61BX>>

82 Po aty.



## Praktikat dhe struktura organizative

Departamenti për Burime Njerëzore (DBNj) në kuadër të PK-së ka për detyrë të zbatojë politikatat që ndërlidhen me personelin dhe trajnimet e ndryshme nëpër të cilat kalojnë punonjësit e këtij institucioni. Sipas rregullave të PK-së, DBNj duhet të sigurojë që rekrutimi i personelit në PK të bëhet sipas kualifikimeve profesionale dhe meritës në kushtet e konkurrencës së drejtë e të transparencës. Në këtë drejtim, puna e DBNj-së shtrihet në ofrimin e një sistemi efikas për menaxhimin dhe zhvillimin e karrierës të të gjithë personelit policor. Gjithashtu, në përshkrimin e detyrave të veta, ky departament duhet të garantojë politika jo-diskriminuese për personelin policor në të gjitha nivelet, përfshirë edhe përfaqësimin e paanshëm gjinor dhe që strukturat e personelit të pasqyrojnë karakterin shumetnik të Kosovës.<sup>83</sup>

Burimet njerëzore në PK janë ngritur, ndihmuar dhe konsoliduar nga bashkësia ndërkombëtare në Kosovë (misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë – UNMIK) e cila ka pas rol vendimmarrës në këtë institucion që prej themelimit (1999) deri në shpalljen e pavarësisë së vendit (2008). Zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore ka vazhduar edhe pas marrjes së kompetencave nga ana e vendorëve. Prandaj, PK-ja është në proces të vazhdueshëm të reformimit sa i përket trajnimeve të zyrtarëve policorë dhe zhvillimit të institucionit<sup>84</sup> me qëllim të ngritjes së qeverisjes së mirë dhe forcimit të integritetit policor.

Siç është përmendur në raportin paraprak, PK-ja renditet në mesin e atyre institucioneve publike të Kosovës me numër të madh të punonjësve, me gati gjithsejtë 9,000 sosh. Për këtë arsye më shumë se gjysma e buxhetit të Policisë shpenzohet në për pagat dhe mëditjet e personelit të PK-së. Sipas tabelës së mëposhtme, numri i përgjithshëm i punonjësve të PK-së është 8,981, prej të cilëve 7,885 ose 88 përqind e tyre janë zyrtarë policorë, gjegjësisht të uniformuar, ndërsa 1,096 ose 12 përqind e zyrtarëve që punojnë në PK i përkasin stafit civil.

83 Për më shumë detaje lidhur me punën e këtij departamenti të Policisë shih: <<http://goo.gl/sZIGmN>>. Qasur më 15 shtator 2016.

84 Transkript nga dëgjimi publik i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, 15 dhjetor 2015, f. 9. Qasur më 15 shtator 2016, në: <<http://goo.gl/qqXmB8>>

**Tabela 1: Numri i të punësuarve (zyrtarët e uniformuar dhe stafi civil) në Policinë e Kosovës<sup>85</sup>**

Personeli	Numri	Përqindja
Zyrtarë policorë	7,885	88%
Stafi civil	1,096	12%
<b>Gjithsej</b>	<b>8981</b>	<b>100%</b>

Sa i përket përfaqësimit gjinor në PK, 86 përqind e personelit janë burra, derisa vetëm 14 përqind punonjësve të Policisë janë gra. Sidoqoftë, sipas kornizës aktuale ligjore është bërë e detyrueshme që përfaqësimi gjinor në institucionet publike të jetë 50 përqind për secilën gjini.<sup>86</sup> Kjo masë e përfaqësimit gjinor do të jetë vështirë të zbatohet duke e ditur se ka mospërputhje të madhe sa i përket përfaqësimit gjinor, veçanërisht në sektorin e sigurisë në Kosovë. Për më tepër, është shprehur skepticizëm nëse kjo dispozitë ligjore do të mund të zbatohet duke u nisur nga fakti që të punësuarit tashmë janë në marrëdhënie pune në institucionet publike, përfshirë PK-në.<sup>87</sup> Pavarësisht kësaj, gjatë rekrutimit të zyrtarëve të rinj policorë, si pasojë e procesit të pensionimit të parakohshëm të zyrtarëve policorë, PK-ja mund të rris numrin e grave në PK.

**Tabela 2: Numri i personelit të Policisë së Kosovës sipas përfaqësimit gjinor<sup>88</sup>**

Personeli sipas gjinisë	Numri	Përqindja
Burra	7729	86%
Gra	1252	14%
<b>Gjithsej</b>	<b>8981</b>	<b>100%</b>

Sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme, pakicat etnike në Kosovë janë mirë të përfaqësuar në institucionin e Policisë. Në këtë drejtim, 7,521 punonjës të PK-së ose 84 përqind e tyre, duke përfshirë stafin civil dhe atë të uniformuar i përkasin popullatës shumicë shqiptare të Kosovës. Ndërsa, 1,460 punonjës të tjerë ose 16 përqind e personelit të PK-së janë nga radhët e pakicave etnike në Kosovë, përfshirë serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkali, egjiptianë dhe pakica të tjera etnike.

85 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015, f. 6. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/H2HvXk>.

86 Neni 6, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

87 Intervistë, Hilmi Jashari, Avokati i Popullit, 25 mars 2016.

88 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015, f. 6. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/H2HvXk>.



**Tabela 3: Numri i personelit të Policisë së Kosovës sipër përfaqësimit etnik<sup>89</sup>**

Personeli sipas përkatësisë etnike	Numri	Përqindja
Shqiptarë	7521	84%
Pakicat	1460	16%
<b>Gjithsej</b>	<b>8981</b>	<b>100%</b>

Nga ana tjetër, një sfidë që vazhdon të përcjellë PK-në viteve të fundit është çështja e ushtruesve të detyrës (UD) për pozita të caktuara brenda Policisë. Edhe pse trendi i UD-ve nga viti 2014 deri në gjysmën e parë të vitit 2016 është në rënie e sipër, megjithatë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) e ka vlerësuar këtë çështje si rrezik të nivelit të lartë. Derisa në vitin 2014 numri i zyrtarëve të emëruar si UD në PK ishte 48, më 2015 numri i UD-ve ishte zvogëluar për 50 përqind më pak, përkatësisht ishin 24 UD, kurse deri në prill të vitit 2016 kanë qenë gjithsej gjashtë sosh, duke u zvogëluar dukshëm në raport me vitet paraprake.<sup>90</sup> Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 mbi marrëdhënien e punës në PK, UD-ja në Polici mund të caktohet në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj të tjerë.<sup>91</sup> Praktika e UD-ve në PK është vlerësuar rrezik i nivelit të lartë nga ZAP-i. Si rrjedhojë, PK-së i është rekomanduar të përcaktoj kontrollë shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit, të cilat duhet të fillojnë me kohë, ndërsa kohëzgjatja e UD-ve të mos jetë më e gjatë se afatet përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ të PK-së.<sup>92</sup>

Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore në PK janë konstatuar dobësi sa i përket dosjeve të personelit në PK. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur se prej vitit 2014 PK-ja nuk i azhurnon kontratat e punës së personelit dhe nuk u bëhet vlerësimi i punës të punësuarve në PK. Këto janë përsëritur edhe në vitin 2015, të cilat janë raportuar nga auditimi që ka bërë ZAP-i gjatë vitit 2016 për PK-në. Nga 23 dosje të personelit të PK-së të cilat ishin testuar nga ZAP-i për vitin 2015, në asnjërën prej tyre nuk ishte bërë vlerësimi i punës për të punësuarit në PK. Prej këtyre dosjeve të shqyrtuara, në dy prej tyre kishin munguar edhe kontratat e punës për personelin e PK-së. Mungesa e vlerësimeve për punën e të punësuarve në PK tregon se kjo mund të ndikojë në dobësimin e integritetit institucional të PK-së. Madje, kjo mund të reflektohet edhe në punën e mëtejshme të të punësuarve të PK-së, duke pamundësuar identifikimin e

89 Po aty.

90 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. (Qershor 2016). Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, f. 23. Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2015-08. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/wfe9m8>.

91 Po aty, f. 23.

92 Po aty, f. 24.



fushave për përmirësimin dhe zhvillimin e tyre në mënyrë profesionale. Ndërsa, edhe pagesat e pagave për të punësuarit që nuk kanë kontratë mund të konsiderohen si të parregullta në aspektin ligjor.<sup>93</sup> Si pasojë e këtyre mangësive, ZAP-i i ka rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe PK-së që kjo çështje të adresohet sa më parë. PK-së i është rekomanduar të përcaktojë kontrolle shtesë në menaxhimin e burimeve njerëzore për të bërë vlerësimin e punës në mënyrë të rregullt vjetore për të gjithë të punësuarit në PK dhe të ketë azhurnim të rregullt të dosjeve për personelin e këtij institucioni të sigurisë.<sup>94</sup>

## Sfidat kryesore

Edhe pse PK-ja për vitin 2016 ka një buxhet relativisht të lartë në shumën prej 85,479,000 Euro,<sup>95</sup> megjithatë ky buxhet është më i vogël në krahasim me buxhetin e vitit 2015 për PK-në që ishte 89,470,530 Euro.<sup>96</sup> Ai është zvogëluar rreth 4 milion më pak ose është më i vogël për afro 5 përqind në krahasim me atë të vitit 2015. Zvogëlimi i buxhetit të PK-së e ka gjetur Qeverinë e Kosovës nën kritika nga njohës të çështjeve të sigurisë dhe zyrtarë të PK-së sipas të cilëve kjo do të mund të dëmtojë procesin e reformave të brendshme të Policisë. Sipas tyre PK-ja ka nevojë urgjente të investojë më shumë në forcimin e kapaciteteve si të atyre teknike, po ashtu edhe në ngritjen e aftësive profesionale e njerëzore.<sup>97</sup> Edhe zyrtarë të lartë të PK-së kanë shprehur shqetësimet se zvogëlimi i buxhetit për vitin 2016 do të vështirësojë edhe më tej arritjen e objektivave të PK-së, siç janë furnizimin me uniforma për zyrtarë policorë, procesin e pensionimit të zyrtarëve policorë, rekrutimin e stafit të ri policor, operacionalizimin e Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe çështje të tjera.<sup>98</sup> Ndërsa, nuk dihet se sa është shumta e buxhetit të PK-së që është shpenzuar deri më tash nga janari deri në muajin shtator të vitit 2016.

Sfidë tjetër, siç është përmendur në raportin e parë monitorues dhe vlerësues për PK-në (për periudhën tetor 2015 – mars 2016), është moshja mesatare e policëve në Kosovë, e cila është 43 vjeç. Kurse, më tepër se 4,000 policë të Kosovë kanë arritur moshën mbi 40 vjeçare, 2,091 sosh janë mbi moshën 46 vjeç, ndërsa rreth 1,000 prej tyre janë

93 Po aty, f. 25.

94 Po aty.

95 Buxheti i Rishikuar i Republikës së Kosovës për vitin 2016, Tabela 2: Përmbledhje e ndarjeve buxhetore (në Euro) dhe Tabela 3.1: Buxheti i Rishikuar për Nivelin Qendror (në Euro), Ligji Nr. 05/L-109 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

96 Policia e Kosovës – Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore. Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës 2015, fq. 17. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/H2HvXk>.

97 Emisioni Puls, “Kush po e rrezikon sigurinë?”, KohaVision (KTV), 21 mars 2016. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/rfxWE0>.

98 Procesverballi i mbledhjes së Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 20 nëntor 2015, f. 4. Qasur më 17 shtator 2016, në: <goo.gl/aQYxll>.



të moshës 55 vjeçare.<sup>99</sup> Kjo i ka hap rrugë pensionimit të parakohshëm të zyrtarëve policorë dhe reformimit të burimeve të personelit policor.

Si pasojë e procesit të reformave për pension të parakohshëm mbi 1,000 zyrtarë policorë të Kosovës pritet të pensionohen. Siç është cekur tashmë në raportin paraprak, për këtë çështje është hartuar Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore, në të cilin parashihet edhe pensionimi i parakohshëm për këto dy institucione e ku thuhet se zyrtaret e këtyre dy institucioneve të cilët kanë autorizime policore fitojnë të drejtën e pensionimit të rregullt atëherë kur arrijnë moshën 55 vjeçare.<sup>100</sup> Megjithatë ky projektligj, në të cilin kanë punuar MPB-ja, PK-ja dhe Sindikata e PK-së nuk është miratuar nga Qeveria as gjatë kësaj periudhe raportuese gjashtëmuajore dhe rrjedhimisht nuk ka kaluar procedurat parlamentare për miratim të mëtejshëm. Ndërkohë, Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së i ka rekomanduar ekzekutivit të ndajë mjetet buxhetore për zbatimin e projektligjit kur të hyjë në fuqi me qëllim të përmirësimit të kuotës së moshës së zyrtarëve policorë.<sup>101</sup>

Pas pensionimit të parakohshëm zyrtarët policorë do të marrin 60 përqind të pagës bruto dhe për këtë është arritur pajtim në mes të PK-së, MPB-së dhe Sindikatës së PK-së.<sup>102</sup> Në këtë drejtim, pritet që rreth 1,000 zyrtarë policorë do të pensionohen dhe 1,000 të tjerë të do të rekrutohen kur të bëhet i plotfuqishëm legjislacioni për pensionimin e zyrtarëve policor. Sa i përket rekrutimit, gjegjësisht punësimit të pjesëtarëve të Policisë, PK-ja do të duhej t'i kushtonte vëmendje më të madhe garantimit të një procesi të drejtë e transparent në përzgjedhjen e kandidatëve për zyrtarë policor. Kjo për arsye që të shmanget çfarëdo mundësie e nepotizmit ose konfliktit të interesit në këtë proces kompleks të reformimit të burimeve njerëzore në PK.

Sfidë tjetër kyçe për policët e Kosovës është mungesa e sigurimit shëndetësor. Kjo çështje nuk është rregulluar nga Qeveria e Kosovës, ndërsa legjislacioni aktual parasheh sigurimin social për zyrtarët policorë, por Qeveria ende nuk ka ndarë buxhet për sigurimin social për policët. Tek prej janarit të vitit 2017 pritet të fillojë sigurimi shëndetësor për punonjësit e Policisë. Për këtë çështje ka zhvilluar takime Sindikata e Policisë me Ministrinë e Shëndetësisë për të gjetur format e sigurimit shëndetësor për personelin policor.<sup>103</sup> Sindikata e PK-së ka njoftuar se prej korrikut të vitit 2016 ka nisur ndalesa

99 Shih: <goo.gl/EQMyUV>. Qasur më 17 shtator 2016.

100 Neni 6, Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore.

101 Procesverbali i mbledhjes së Komisionit parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 22 dhjetor 2015, f. 3. Qasur më 15 shtator 2016, në: <goo.gl/XmigBY>.

102 Po aty.

103 Shih: <goo.gl/3eLZ7T>. Qasur më 15 shtator 2016.



e mjeteve për fondin e sigurimeve shëndetësore për zyrtarët policorë. Në këtë mënyrë, kontributi në fondin e sigurimeve shëndetësore do të jetë 7 përqind prej pagës bazë të zyrtarëve policorë, ku 3.5 përqind do të paguhet nga i punësuari dhe 3.5 përqind të tjera nga punëdhënësi.<sup>104</sup> Sidoqoftë, nuk ka të dhëna nëse kjo ka nisur ta zbatohet.

Përveç mungesës së sigurimit shëndetësor, policët e Kosovës nuk e gëzojnë as sigurimin jetësor në rast të humbjes së jetës apo invalidimit në kuadër të punës zyrtare. Ky lloj sigurimi është i nevojshëm për çdo zyrtar policor për shkak të lëndimeve serioze dhe plagëve që mund të marrin në detyrë. Në mungesë të sigurimit jetësor policët të cilët pësojnë nga lëndimet nuk marrin as dëmshpërblime për plagët, me përjashtim të ndihmave për tretman mjekësor që marrin për lëndime.<sup>105</sup>

---

104 Po aty.

105 Intervistë, Kreshnik Gashi, Redaktor në BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese), 3 prill 2016.



# MENAXHIMI FINANCIAR

## Prokurimi publik

Sektori i prokurimit publik në Kosovë është i rregulluar përmes Ligjit për Prokurimin Publik, i cili ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme. Ky ligj ishte kritikuar vazhdimisht se nuk ishte në përputhje me rrethanat dhe se ishte bërë pengesë për funksionimin e mirë të aktiviteteve të prokurimit publik. Sikur institucionet tjera publike në Kosovë, edhe PK-ja i nënshtrohet këtij ligji kur bëhet fjalë për aktivitetet e prokurimit publik. Me ndryshimet e reja të Ligjit për Prokurimin Publik në vitin 2016, për herë të parë rregullohet se kur zbatohen rregullat e këtij ligji për kontratat në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Duke e marrë parasysh ndjeshmërinë e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë, ka raste kur për disa lloje të kontratave zbatohen procedura të veçantë të prokurimit publik, gjegjësisht me atë rast nuk zbatohen rregullat e Ligjit për Prokurim Publik. Në këtë mënyrë, ligji nuk zbatohet për furnizimin me pajisje të ndryshme, si dhe për prokurimet në punët dhe shërbimet e ndjeshme. Ligji nuk zbatohet as për furnizim të pajisjeve ushtarake.<sup>106</sup> Për këto aktivitete duhet të miratohet një Rregullore nga Qeveria e Kosovës mbi prokurimin për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë, e cila ende nuk është miratuar nga kjo e fundit. Ndërsa, rastet kur nuk zbatohet Ligji i ndryshuar e as Rregullorja është kur bëhet fjalë për ato kontrata ku zbulimi i informacionit mund të cenojë interesat thelbësore të sigurisë së vendit<sup>107</sup> dhe për raste të tjera. Në këto situata ndiqen rregulla të veçanta të prokurimit publik. Këto ndryshime në Ligjin për Prokurimin Publik janë bërë si pasojë e kërkesave të Bashkimit Evropian për harmonizimin e ligjit me legjislacionin e BE-së, gjegjësisht Direktivën nr. 2009/81/EC<sup>108</sup> për kontratat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë kësaj periudhe është raportuar për parregullsi dhe dobësi gjatë procedurave të disa tenderëve në kuadër të aktiviteteve të prokurimit publik të Policisë. Në këtë drejtim, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka marrë 13 vendime në vitin 2016 (deri në shtator 2016) në bazë të ankesave të operatorëve ekonomikë për tenderë të caktuar që kanë të bëjnë me Policinë. Disa prej vendimeve të marra nga ana e OSHP-së kanë nxjerrë në pah se PK-ja si autoritet kontraktues nuk vepron në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik.

Parregullsitë dhe vërejtjet më të mëdha OSHP-ja i kishte lidhur me aktivitetin e pro-

106 Neni 3, Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237.

107 Po aty.

108 Shih: <goo.gl/UsM0V1>. Qasur më 15 shtator 2016.



kurimit të Policisë për furnizim me pajisje trafiku alkotesta. Kundër PK-së kishte ushtruar ankesë në OSHP operatori ekonomik “Medicom”. Kjo kompani ishte ankuar se PK-ja nuk i kishte respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. Në fakt, Policia e kishte anuluar këtë aktivitet prokurimi në mungesë të dy ofertave të përgjegjshme. Megjithatë, OSHP-ja kishte pasur vërejtje për mënyrën se Policia si autoritet kontraktues ka hartuar dosjen e tenderit dhe rrjedhimisht kishte kufizuar pjesëmarrjen e më shumë operatorëve ekonomikë për këtë aktivitet të prokurimit.<sup>109</sup>

Vendimet tjera të OSHP-së për vitin 2016 sa i përket aktiviteteve të prokurimit publik të PK-së kanë konstatuar se disa prej ankesave të operatorëve ekonomikë ishin refuzuar si të pabazuara, qoftë për shkak se nuk kishte ofertues të përgjegjshëm, qoftë për shkak se operatorët ekonomikë nuk kishin plotësuar kushtet e dosjeve të tenderit siç ishin kërkuar nga Policia.<sup>110</sup>

Përveç OSHP-së, edhe ZAP-i kishte vërejtur mangësi sa i përket respektimit të rregullave të prokurimit publik nga ana e PK-së. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, ZAP-i kishte gjetur se për mirëmbajtjen e automjeteve, PK-ja i kishte 19 kontrata aktive përmes procedurës së hapur të prokurimit. Megjithatë, në vitin 2015, PK-ja kishte lidhë edhe 15 kontrata tjera, duke ju shmangur procedurave të hapura të tenderimit, përmes procedurës së koutimit të çmimit në vlerë prej 35,695 Euro. PK-ja ishte arsyetuar se ka vepruar kështu për shkak të shumëllojshmërisë së automjeteve që i posedon si institucion. Por, ZAP-i në raportin e auditimit kishte vlerësuar se PK-ja në këtë mënyrë kishte bërë planifikim të dobët sa i përket prokurimit.<sup>111</sup> Për më tepër, kjo procedurë prokurimi ishte parë me rrezik meqë mund të dëmtoj konkurrencën dhe të vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve të pranuar për paranë e dhënë. Rrjedhimisht, ZAP-i kishte rekomanduar që ministri i Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojnë që Zyra e Prokurimit e PK-së ka bërë analizë të mirëfilltë para procesit të planifikimit në mënyrë që kërkesat për shërbimet e njëjta të tenderohen përmes procedurave të kontratave kornizë për t’ju shmangur lidhjes së kontratave më kuotim të çmimeve.<sup>112</sup>

Dobësi ishin raportuar edhe në realizimin e projekteve të caktuara të PK-së, ku ishin shkaktuar vonesa në kryerjen e punëve nga ana e operatorëve ekonomikë. Kontrata “Ndërtimi i Depos për Ruajtjen e Materialeve të Rrezikshme në Kampin e Vrellës

109 Shih vendimin e OSHP-së këtu: <goo.gl/MSNuKx>. Qasur më 15 shtator 2016.

110 Për më tepër informata, shih vendimet e OSHP-së për aktivitetet e prokurimit publik të PK-së: <goo.gl/U04Qw1>. Qasur më 15 shtator 2016.

111 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. (Qershor 2016). Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, f. 17. Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2015-08. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/wfe9m8>.

112 Po aty.



në PK” në vlerë prej 29,928 Euro ishte përfunduar me 137 ditë vonesë, derisa afati për përbushjen e kontratës kishte qenë jo më shumë se 30 ditë kalendarike. Ndërsa, kontrata tjetër “Furnizimi dhe Vendosja e Dyerve me Senzor dhe Rregullimi i Shkalëve Emergjente në Objektivin e Administratës së PK-së” e cila kapte shumë prej 9,182 Euro kishte përfunduar me 22 ditë vonesë. Vonesa ishin vërejtur edhe për renovimin e sallës së Drejtorisë Rajonale të Policisë (DRP) në Ferizaj në vlerën prej 25,370 Euro. Operatori ekonomik i kishte gjithsej 75 ditë kalendarike për përfundimin e punimeve, ndërsa i kishte kryer me 115 ditë vonesë.<sup>113</sup> Këto vonesa ZAP-i i ka klasifikuar si rrezik të nivelit të mesëm që mund të zbeh efikasitetin e operacioneve të PK-së dhe kjo e fundit të dështojë në arritjen e objektivave. Gjithashtu, dështimi për të kryer me kohë kontratat mund të ndikojë në rritjen e obligimeve në fund të vitit dhe ato të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.<sup>114</sup> Rrjedhimisht, ZAP-i në raportin për pasqyrat financiare të MPB-së i ka rekomanduar ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së se duhet të respektohen afatet për përbushjen e kontratës dhe për këtë duhet të forcohen më shumë kontrollet në proceset e planifikimit, monitorimit dhe realizimit të projekteve kapitale duke analizuar njëkohësisht pengesat e mundshme për realizimin e kontratave.

Përveç realizimit të kontratave, vonesa kishte pasur edhe sa i përket ekzekutimit të pagesave nga PK-ja për operatorët ekonomikë duke mos arritur t’i respektojë afatet ligjore.<sup>115</sup> Vonesa e shkaktuara nga PK-ja në mosekzekutimin e pagesave, sipas ZAP-it, rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj operatorëve ekonomikë. Më tej, kjo rritë rrezikun e dështimit të pagesave për mungesë të fondeve dhe bartjen e obligimeve për vitin vijues.<sup>116</sup> Në këtë mënyrë, ZAP-i i ka rekomanduar PK-së se duhet të mbikëqyrë rregullisht procesin e realizimit të buxhetit për të bërë pagesën e faturave në kuadër të afateve ligjore.

Një mangësi tjetër gjatë aktiviteteve të PK-së në fushën e prokurimit publik ka të bëjë me certifikim jo të rregullt të pagesave. Të dhënat nga ZAP-i konstatojnë që si pasojë e planifikimit të dobët nga PK-ja mund të çojë deri te rreziku që vlera e faturave të jetë më e lartë sesa vlera e planifikuar për këtë qëllim. Rrjedhimisht, ZAP-i ka rekomanduar që PK-ja duhet të sigurojë kontrolle shtesë te njësitë kërkuese me qëllim që kërkesat të jenë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të saktë. Në veçanti, i është rekomanduar Zyrtarit Certifikues që të kontrollojë të gjitha pagesat për të verifikuar nëse ato janë në pajtim me kontratat.<sup>117</sup>

113 Po aty, fq. 18-19.

114 Po aty, f. 19.

115 Po aty, f. 20.

116 Po aty.

117 Po aty, f. 21.



Ndërkohë, gjatë vitit 2015 tre tenderë të Policisë janë hetuar nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK): furnizimi me uniformë të për PK-në, ndërtimi i objektit K9 dhe lënda e tenderit për rregullimin e poligonit për gjuajte me armë zjarri. Nuk ka informacione për zhvillimin e këtyre hetimeve dhe nëse është gjetur ndonjë parregullsi gjatë aktivitetëve të prokurimit publik në lëndët e këtyre tenderëve.

Përveç këtyre dobësive në prokurim publik të PK-së, sfidë tjetër në këtë institucion mbeten disa çështje lidhur me menaxhimin dhe kontrollin financiar të PK-së. Që prej vitit 2012 një numër i konsiderueshëm i automjeteve të PK-së presin për t'u riparuar dhe mirëmbajtur. Në autoparkun e flotës së PK-së janë 131 automjete ose rreth 10 përqind nëse krahasohet me numrin total të automjeteve të PK-së, të cilat kanë mbetur ende pa u riparuar. Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së pjesëve rezervë, numrit të vogël të stafit në këtë shërbim dhe për shkak të vjetërsisë së këtyre automjeteve.<sup>118</sup> Kjo sfidë është identifikuar si rrezik me prioritet të lartë nga ZAP-i, ndërsa i kanë bërë thirrje ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së të shqyrtojnë arsyet pse kjo çështje nuk është adresuar deri më tash. Po ashtu, ZAP-i ka rekomanduar të përcaktohen masat shtesë për forcimin e kontrolleve në këtë njësi sa i përket automjeteve të PK-së me qëllim të identifikimit të defekteve dhe riparimit të tyre për të shmangur pritjet e gjata të automjeteve për riparim si dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i tyre.<sup>119</sup>

118 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. (Qershor 2016). Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, f. 28. Nr. i Dokumentit: 21.16.1-2015-08. Qasur më 16 shtator 2016, në: <goo.gl/wfe9m8>.

119 Po aty.



## REKOMANDIME

- ▶ Kuvendi i Kosovës duhet të jetë më aktiv dhe roli i tij të jetë më i madh në mbikëqyrjen demokratike të Policisë së Kosovës. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës të investojë në burime profesionale duke angazhuar ekspertë për të ushtruar mbikëqyrje të mirëfilltë parlamentare të sektorit të sigurisë, veçanërisht në Polici. Kapacitetet aktuale të komisionit janë të pamjaftueshme në mbikëqyrjen e shpenzimeve financiare të Policisë dhe të zbatimit të legjislacionit të Policisë së Kosovës. Nga ana tjetër, Policia të adresojë rekomandimet e këtij komisioni sa i përket zbatimit të Ligjit për Policinë.
- ▶ Të inkurajohen zyrtarët policor dhe stafi civil i Policisë që në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në vendin e punës të ushtrorjnë ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Zyrtarët që ushtrorjnë ankesë për shkelje të të drejtave të njeriut të mos bëhen subjekt i diskriminimit, viktimizimit ose hakmarrjes nga eprorët e tyre në Polici.
- ▶ Policia e Kosovës të adresojë rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me shpenzimet dhe kontrollin financiar sipas raporteve vjetore të auditimit.
- ▶ Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, duhet të hartojnë Planin e Integritetit për zhvillimin profesional të institucionit të Policisë. Ky plan duhet të ketë si qëllim parandalimin dhe luftimin e keqpërdorimeve në Polici si dhe të aferave të mitos e korrupsionit policor. Në vijim ky plan:
  1. Duhet të parandalojë dhe luftojë abuzimet me shpenzimet financiare të buxhetit të Policisë dhe veçanërisht sa i përket keqpërdorimeve të mundshme në aktivitetet e prokurimit publik të Policisë së Kosovës.
  2. Duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë parandalimit të keqpërdorimit të pozitës zyrtare të personelit policor gjatë detyrës zyrtare.
  3. Mekanizmat kontrollit të brendshëm dhe ata disiplinorë të Policisë së Kosovës duhet të forcohen më shumë. Ato duhet të jenë të pavarura nga niveli udhëheqës i Policisë për arritjen e këtyre objektivave të përmendura më sipër me synim të zbatimit të Planit të Integritetit dhe luftimit të korrupsionit policor.
- ▶ Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës dhe zyrtarët policorë duhet të inkurajohen për të denoncuar zyrtarët e Policisë, përfshirë nivelin e lartë udhëheqës të këtij institucioni, kur dyshohen për vepra të ndryshme penale. Për



realizimin e këtyre qëllimeve duhet të fuqizohen edhe më shumë mekanizmat e brendshëm të Policisë së Kosovës, por edhe mekanizmat e Departamentit të Hetimeve për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar brenda Policisë së Kosovës.

- ▶ Inspektorati Policor i Kosovës duhet të jetë më aktiv në mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës, veçanërisht për zyrtarët policorë me grada të lartë në dhe nivelin udhëheqës të Policisë së Kosovës. Ajo duhet të hetoj dhe inspektoj gjithashtu aktivitetet e ndryshme të Policisë së Kosovës në baza të rregullta.
- ▶ Deri në fund të vitit 2016 duhet të miratohet Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore për t'i hapur rrugë pensionimit të parakohshëm të zyrtarëve policorë. Qeveria e Kosovës duhet të ndajë në vitin 2017 mjetet e nevojshme buxhetore për procesin e pensionimit të parakohshëm të zyrtarëve policorë. Ndërsa, Policia e Kosovës duhet të bëjë planifikimet dhe përgatitjet e nevojshme të reformimit të burimeve njerëzore për rekrutimin e zyrtarëve të rinj policorë duke garantuar konkurrencë të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët e interesuar për punësim në Polici.
- ▶ Në fillim të vitit kalendarik 2017 Qeveria e Kosovës duhet të ndajë mjetet buxhetore lidhur me sigurimin shëndetësor të personelit policor dhe sigurimin jetësor në rast të humbjes së jetës apo invalidimit të zyrtarëve policorë në kuadër të punës zyrtare. Në këtë drejtim, menaxhmenti i Policisë dhe Sindikata e Policisë së Kosovës duhet të këmbëngulin që të dyja sigurimet të garantohen për personelin e Policisë.
- ▶ Policia e Kosovës duhet të respektojë procedurat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik sa i përket përgatitjes së dosjeve të tenderëve. Gjatë aktiviteteve të prokurimit publik Policia nuk duhet të kufizojë në asnjë mënyrë pjesëmarrjen e më shumë operatorëve ekonomikë në aktivitetet e prokurimit, siç ka ndodhur tashmë disa herë. Policia e Kosovës duhet të sigurojë proces të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.
- ▶ Policia e Kosovës të ushtrojë mbikëqyrje të mirëfilltë ndaj operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratave dhe projekteve të Policisë sipas afateve të përcaktuara kohore. Duhet të respektohen në mënyrë të saktë afatet për përmbushjen e kontratave për arritjen e objektivave të Policisë dhe kryerjen me efikasitet të operacioneve të Policisë. Në rast të vonesave në realizimin e kontratave, Policia duhet të ndëshkojë, sipas masave ligjore, moskryerjen e punëve me kohë nga operatorët ekonomikë.



- ▶ Policia e Kosovës duhet të ekzekutojë pagesat ndaj operatorëve ekonomik duke respektuar afatet ligjore. Vonesat në ekzekutimin e pagesave bartin me vete rreziket që do të bëhen pagesa shtesë të dëmshpërblimeve në llogari të operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, Policia e Kosovës duhet të mbikëqyrë në mënyrë të rregullt realizimin e buxhetit të vet për të ekzekutuar pagesën e faturave sipas afateve të përcaktuara ligjore.
- ▶ Policia e Kosovës duhet të menaxhojë më mirë pasuritë, veçanërisht flotën e saj të automjeteve. Numri i lartë prej 131 automjeteve, të cilat ka disa vite që kanë mbetur të riparuar, tregon se ka nevojë për menaxhim me efikas të pasurisë nga ana e Policisë. Gjithashtu, duhet të identifikohen shkaqet e pritjes së gjatë të automjeteve për t'u mirëmbajtur dhe riparuar.
- ▶ Ligji aktual për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës sa i përket konfliktit të interesit. Ligji duhet të parashihet që konflikti i interesit është vepër penale (sikurse është me Kodin Penal) dhe jo siç është aktualisht si kundërvajtje.
- ▶ Pavarësisht deklarimit të pasurisë dhe dhuratave nga zyrtarët e lartë të Policisë së Kosovës tek Agjencia Kundër Korrupsionit, megjithatë nuk dihet se deri në çfarë mase këto informacione janë të sakta. Prandaj, Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të verifikojë saktësinë e të dhënave që merr nga Policia lidhur me deklarimin e pasurisë.

# POINTPULSE

WESTERNBALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST



[WWW.POINTPULSE.NET](http://WWW.POINTPULSE.NET)



[twitter.com/POINTPULSEnet](https://twitter.com/POINTPULSEnet)



[facebook.com/POINTPULSEnet/](https://facebook.com/POINTPULSEnet/)